



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.06.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 19, 20, 27 prill 2022 dhe 10 maj 2022
2. Miratimi i kalendarit tre javor të punës për periudhën 30 maj – 17 qershor 2022 si dhe i programit të punës për periudhën 30 maj – 1 korrik 2022
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin “Përmirësimi i Sistemit të Shëndetësisë” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etilda Gjonaj, Blendi Klosi, Besion Ajazi, Hatixhe Konomi, Pandeli Majko, Greta Bardeli, Bardhyl Kollçaku, Vangjel Dule, Klodiana Spahiu, Kreshnik Çollaku, Petro Koçi, Etjen Xhafaj, Tomor Alizoti, Etilda Gjonaj, Ilir Pendavinji dhe Tritan Shehu.

Mungojnë:

Lavdrim Krashi, Shpëtim Idrizi, Belind Këlliçi dhe Grida Duma.

Të ftuar:

Vjollca Braho – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Antoneta Njehrrera – Drejtoreshë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Mejvis Kola – Drejtoreshë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Saimir Kadiu – Drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Kesjana Halili - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica – Drejtoreshë në Drejtorinë e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj, Drejtorja e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Evis Fico- Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli - Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme datë 7 qershor 2022. Në rendin e ditës kemi: miratimin e procesverbaleve të datave 19, 20, 27 prill 2022 dhe 10 maj 2022; miratimin e kalendarit tre javor të punës për periudhën 30 maj – 17 qershor 2022, si dhe i programit të punës për periudhën 30 maj – 1 korrik 2022 dhe projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin “Përmirësimi i Sistemit të Shëndetësisë”, jemi komision për dhënie mendimi, relatores zonja Spahiu. Të ftuar janë: zonja Vjollca Braho, zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; zonja Antoneta Njehrrëna; zonjën Mejvis Kola, zoti Saimir Kadiu; zonja Kesjana Halili; zonja Elona Mistrovica dhe zonja Evis Fico, mirë se erdhët, zonja të nderuara!

Fillojmë pa humbur kohë me miratimin e procesverbaleve. Kush është dakord me procesverbalet? Dakord.

A jeni dakord me miratimin e kalendarit 3-javor për periudhën 30 maj – 17 qershor 2022, si dhe i programit të punës për periudhën 30 maj – 1 korrik 2022? Dakord.

Faleminderit kolegë!

Vazhdojmë me projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së huas. Fjala për zonjën Braho.

Vjollca Braho- Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin “Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë”.

Qëllimi i projektligjit është të kontribuojë në modernizimin e shërbimeve të përzgjedhura spitalore publike dhe të mbështesë rindërtimin e objekteve të përzgjedhura mjekësore të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019.

Marrëveshja e re do të garantojë vijueshmërinë e objektivit tonë madhor për të transformuar sistemin tonë shëndetësor në një sistem të integruar, harmonik dhe të aksesueshëm, ku në qendër është shërbimi ndaj qytetarëve.

Marrëveshja vjen në kuadër të pasojave të tërmetit të 29 nëntorit të vitit 2019, ku Banka Botërore u angazhua për mbështetje në vlerën e 25 milionë eurove për rindërtimin e objekteve shëndetësore, në kuadër të programit qeverisës 2021-2025, ku rindërtimi është një

nga shtyllat kryesore të financimit dhe kjo kontratë do t'i hapë rrugën financimit të objekteve shëndetësore.

Projekti financohet në masën 100% nga Banka Botërore, përfshirë edhe taksat e lindura në territorin e Shqipërisë, pra, nuk parashikohet rimbursim i detyrimeve tatimore.

Financimi shtesë në vlerën 25 milionë euro për projektin e përmirësimit të sistemit shëndetësor në Shqipëri do të mundësojë përshkallëzim të mëtejshëm të aktiviteteve të projektit mëmë dhe do të sigurojë ndikim të drejtpërdrejtë te përfituesit dhe përmirësim të mëtejshëm të ofrimit të shërbimit të kujdesit spitalor në vend.

Ky projekt përbëhet nga këto komponent kryesorë:

Komponenti i parë është përmirësimi i menaxhimit të infrastrukturës spitalore të spitaleve publike me një vlerë 18 760 000 euro; komponenti i dytë është përmirësimi i menaxhimit të informacionit shëndetësor për shërbimin spitalor në vlerën 4,4 milionë euro; komponenti i tretë është monitorimi, vlerësimi dhe menaxhimi i projektit në vlerën 900 000 euro, si dhe fondet e konvergencës.

Të ndara sipas alokimit të fondeve në zërat punime civile janë në vlerën 13 milionë e 900 mijë lekë, të cilat zënë 55,6% të totalit; në zërin mallra janë 18 milionë e 900 mijë euro, të cilat zënë 35,6% të totalit dhe shërbimet e konsulencës, trajnime dhe kosto operative në vlerën 2,2 milionë dhe që zënë 8,8% të totalit.

Për sa i përket komponentit të parë, që është përmirësimi i menaxhimit të infrastrukturës spitalore, në vlerën 13,9 milionë euro, do të bëhet i mundur rikonstruksioni dhe rehabilitimi i 5 spitaleve, ku në të përfshihen; rehabilitimi i spitalit të Krujës, të Lezhës, rehabilitimi i shërbimit të kardiologjisë në QSUT, rehabilitimi i spitalit psikiatrik në QSUT, rehabilitimi i spitalit të djegieve plastike në QSUT, si dhe blerja e pajisjeve mjekësore, si dhe mobilimin e ambienteve të këtyre 5 spitaleve që do t'u bëhet rikonstruksioni i tyre.

Një rëndësi mjaft të madhe në këtë komponent është edhe forcimi i kapaciteteve të menaxhimit të sektorit të spitaleve publike që do të realizohen, duke përfshirë përditësimin e masterplanit ekzistues të spitaleve dhe rishikimin e kuadrit rregullator dhe ligjor; kryerjen e një vlerësimi të menaxhimit aktual të QSUT, si dhe rekomandimet që do të jepen për të; përditësimi i udhëzuesve klinikë dhe protokolleve për sëmundjet kronike prioritare, krijimi i llogarive kombëtare të shëndetit, zhvillimi dhe zbatim i aktiviteteve komunikuese për informimin e publikut për reformën që po merret në shërbimin shëndetësor te spitalet.

Për sa i përket komponentit të dytë, që është përmirësimi i sistemit të menaxhimit të informacionit shëndetësor për shërbimin spitalor është në vlerën 4,4 milionë euro dhe ky aktivitet do të jetë vazhdimësi e aktiviteteve të zbatuara në projektin mëmë, ku ne e kemi

zhvilluar në katër spitale. Kjo është realizuar në spitalin e Durrësit, ku është duke u punuar dhe deri në fund të vitit do të përfundojë shtrirja e këtij sistemi edhe në spitalin e Vlorës dhe të Shkodrës. Pra, me këtë hua që ju do të miratoi sot do të bëhet shtrirja e këtij sistemi edhe në 7 spitalet e tjera, si: në Dibër, Kukësit, Beratit, Gjirokastrës, Lezhës, Fierit dhe Korçës. Pra, do të bëhet e mundur që të gjitha shërbimet që merr qytetari që në momentin që futen në spital dhe deri në momentin kur del nga spitali të jetë i gjithë procesi dhe ana dokumentare mjekësore do të jetë e digjitalizuar dhe çdo pacient do të ketë kartelën elektronike shëndetësore, si dhe historikun e diagnozave që ka dhe të gjitha medikamentet që kanë marrë gjatë kohës që ka qëndruar në spital. Në këtë komponent financimi përfshin edhe licencat e softwerat dhe aktivitetet për trajtime shtesë, si dhe për blerjen e pajisjeve kompjuterike për këto spitale që do të bëhet shtrirja e gjithë sistemit HIS. Financimi shtesë do të mundësojë përshkallëzim të mëtejshëm të aktiviteteve të projektit mëmë dhe do të sigurojë ndikim të drejtpërdrejtë te përfituesit dhe përmirësim të mëtejshëm të ofrimit të shërbimit të kujdesit spitalor në vend.

Ne do të vijojmë të garantojmë që çdo qytetar të marrë shërbimin shëndetësor dhe të jetë sa më i aksesueshëm dhe sa më afër vendbanimeve, duke filluar nga diagnostikimi në kohë dhe me cilësi të aparaturave biomjekësore të standardeve më të mira në rrjetin e spitaleve tona publike.

Sa i përket komponentit të tretë, shërbime të konsulencës, shpenzime trajnimi dhe kostot operative, kostot operative në këtë kredi janë mjaft të ulëta, ato zënë 8,8% të totalit të përgjithshëm të kredisë së marrë, duke e krahasuar edhe me kredinë mëmë, që ishte e miratuar, por përqindja ka qenë më e lartë në krahasim me këtë kredi.

Financimi shtesë do të mbështesë më tej reformën spitalore, që rrjedh nga masterplani i spitaleve, si një parakusht për racionalizimin e nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor në Shqipëri dhe përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit e përmirësimit të cilësisë së spitaleve.

Mbështetur në rezultatet e projektit mëmë, si modernizimi i pajisjeve diagnostikuese mjekësore në 11 spitalet rajonale, rikonstrukcioni i spitalit pediatrik në spitalin “Nënë Tereza”, godina e re e spitalit të Laçit, si dhe aktivitetet e parashikuara nga financimi shtesë përputhen plotësisht me agjendën e zgjeruar të reformës për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit shëndetësor në Shqipëri.

Rezultatet e projektit mëmë kanë inkurajuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ndjekjen e një reforme më të thellë në nivelin sekondar të kujdesit, duke filluar me përmirësimin e mëtejshëm të kujdesit diagnostik, optimizimin e plotë të shërbimeve

spitalore rajonale, transformimin e shërbimeve në spitalet e përzgjedhura bashkiake dhe zbatimi i sistemit të informacionit shëndetësor në spitalet rajonale.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Ishit më shumë se shteruese, kështu që mendoj se edhe nëse kishim një pyetje teknike lidhur me atë çfarë kjo marrëveshje përfaqëson, i keni ezuaruar në përmbledhjen tuaj.

Doktoreshë Spahiu, fjala për ju.

Klodiana Spahiu - Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë,

Kjo është një marrëveshje huaje shumë e rëndësishme, por që pjesa kryesore është miratuar që në vitin 2015 dhe që prej asaj kohe ne e dimë që janë realizuar një sërë projektesh si në infrastrukturë, por, mbi të gjitha, edhe në digjitalizim.

Meqenëse zonja zëvendësministre ishte e detajuar në mënyrën sesi do të menaxhohet kjo hua, unë do të fokusohem në tre komponentët kryesorë që ka huaja.

Komponenti i parë dhe më kryesorë që zë peshën më të madhe në këtë hua është përmirësimi i menaxhimit të infrastrukturës spitalore të spitaleve publike. Ne e dimë që investimet në spitalet publike asnjëherë nuk do të mjaftonin, gjithmonë do të ishin pak dhe të gjithë ne këtu do të thoshim që do të na duhen më shumë, megjithatë ne duhet të kuptojmë një gjë të rëndësishme që për menaxhimin e spitaleve ne duhet të bëjmë një hap tjetër, që është ai drejt autonomisë spitalore. Ky projektligj ka ardhur në parlament dhe do të diskutohet shumë shpejt në komisionet parlamentare. Të gjitha këto ndryshime që zëvendësministrja i përmendi janë në funksion të përmirësimit të punës në spitalet publike.

Komponenti i dytë dhe besoj se është shumë i rëndësishëm për të gjithë është

përmirësimi i menaxhimit të informacionit shëndetësor. Janë hedhur hapat e parë që në vitin 2014, duke filluar me sistemin parësor që duhet ta pranojmë që tashmë është pjesa më e madhe e digjitalizuar dhe janë bërë një sërë hapash duke filluar nga receta elektronike, më pas nga mënyra sesi aplikohet për të marrë një vizitë dhe më pas me të gjithë informacionin e duhur që tashmë secili nga ne e ka në kartën e tij të shëndetit, elektronike edhe kjo. Hapi që do të vazhdojë në 7 spitalet rajonale është i filluar në 4 spitale, në atë të Durrësit, të Vlorës, të Shkodrës dhe të fierit dhe tentohet që të digjitalizohet çdo gjë në një spital publik, duke filluar nga farmacia deri kur pacienti del nga spitali dhe kjo është shumë e rëndësishme, sepse është një memorie për secilin për të gjithë historinë e tij shëndetësore.

Komponenti i tretë është monitorimi, vlerësimi dhe menaxhimi i projektit.

Këto janë tre komponentët kryesorë të kësaj huaje, që, siç ju thashë, është një hua, e cila ka filluar që në vitin 2015 dhe kjo është një shtesë, por, mbi të gjitha, është një mbështetje për të gjitha institucionet e dëmtuara nga tërmeti në vitin 2019.

Ne e kemi kaluar dje në komision dhe e patëm edhe ne një informacion shumë shterues nga ministrja e Shëndetësisë. Shuma 25 milionë euro nuk është e madhe, por janë të menaxhuara në mënyrë të tillë që ne të kemi një performancë në rritje në nivelin e spitaleve tona publike.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, doktoreshë Klodi!

Fjala për zotin Kollçaku, të përgatitet zoti Çollaku.

Bardhyl Kollçaku - Faleminderit, zonja kryetare!

Dëgjuam me vëmendje zëvendësministren dhe kisha mundësi ta dëgjoja edhe në Komision të Ligjeve dhe është gjë e mirë për Ministrinë e Shëndetësisë jo vetëm kushtet financiare që merret kjo hua, por edhe qëllimi pse do të përdoret.

Unë kam një pyetje lidhur me databazën që do të ketë evidenca mjekësore. A do të ketë një ndërveprim me spitalet private në Shqipëri, nëse po, cilat janë kushte e ruajtjes së konfidencialitetit?

Pyetja tjetër lidhet me databazën e strukturave të sigurisë, që janë: Ministria e Mbrojtjes, SHISH-i, Ministria e Brendshme, nëse ka, dhe si do të ruhet, sepse ka të bëjë shumë ruajtja e konfidencialitetit?

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Përpara se t'ia jap fjalën zotit Çollaku për pyetjet e tjera dua të them diçka. Unë besoj se ka një ligj që rregullon konfidencialitetin dhe të dhënat e personave që punojnë në struktura, e cila afekton edhe kartelën shëndetësore të çdo individi, që, në fakt, duhet të jetë konfidenciale, pavarësisht nëse je qytetar i thjesht apo punon në strukturat e agjencive apo shërbimeve të tjera, ku konfidencialiteti është në doza më të shtuara.

Zot Çollaku, fjala për ju.

Kreshnik Çollaku- Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të sqaroj që në fillim që unë nuk e konsideroj veten specialist të sistemit shëndetësor, kështu që për ndonjë pasaktësi mund të më korrigjoni.

Në një vështrim të parë që unë i bëj materialit që keni paraqitur kam disa pikëpyetje dhe koment.

Në radhë të parë duket se është një histori sikur fillon sot, por unë mendoj dhe duket se nuk është diçka që po ndodh sot për herë të parë. Pra, historia e këtyre financimeve e ka

një cikël të shkuar. Unë nuk dua ta politizoj, por nga një situatë ku u premtua shëndetësi falas, në një situatë ku duhet të marrim borxhe, huaja është borxh dhe 25 milionë euro nuk janë shumë, por nuk janë as pak, sepse do të paguhen nga qytetarët shqiptarë, mendoj se duhet një lloj qartësie më e madhe më e madhe për destinacionin e këtyre fondeve. Unë mendoj se në material mungon një raportim i qartë se çfarë janë përdorur në ciklin e parë të një huaje të tillë në të shkuarën, apo sa janë përdorur fondet e dislokuara për të tilla ndërhyrje në të shkuarën. Megjithatë, shëndeti nuk ka çmim dhe në rast se do të ishte një destinacion i drejtpërdrejtë për zhvillimin, perfeksionimin dhe rehabilitimin e qendrave shëndetësore, që, me ju thënë të drejtën, në shumë zona, edhe në zonën time në qarkun e Dibrës, janë në situata katastrofale. Patjetër që borxhi mund të merret dhe mund ta përballojnë taksapaguesit shqiptarë dhe ne të gjithë, sepse, në fund të fundit, jeta nuk ka çmim, por ndërsa unë shoh që në qarkun tim ka qendra shëndetësore të rrënuara, në kuptimin e plotë të fjalës, ku nuk ka mjekë apo obstetër në shtëpinë e lindjes në Burrel, shoh që në atë që me taksat tona do të paguhen është një projekt, kundër të tjera thuhet: “Do të mbulohen zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve komunikuese mbi informimin publik për reformat në spitale”, kjo është politike dhe jo ndërhyrje në shëndetësi. Pra, që të marrësh një borxh dhe ta harxhosh që të bësh aktivitet komunikues për informimin publik për reformat në spitale kjo është propagandë, ose sondazhe dhe studime në lidhje me projektin, edhe kjo është propagandë. Pra, nuk ka një ndarje të qartë çfarë është për të ndihmuar sistemin dhe çfarë është për të mbuluar gropat deri sot. mendoj se kjo do një sqarim. unë nuk dua të bëj akuzatorin, por, sigurisht, jam dyshues për këtë performancë të këtij materiale. Edhe të tjera zëra që lidhen me rekrutimet, punësimet, drejtues projekti, menaxhues projekti janë para që shpenzohen. Mund të ishte një situatë normale dhe perfekte, por kur ka zona të tëra që, në fakt, aq sa paguhet një drejtor i një projekti të tillë mund të paguhet një gjinekolog për spitalin e lindjes në Burrel, më falni, por është e tepërt. Përveç nevojës për të shëruar sistemin shëndetësor duhet të mbajmë përgjegjësinë për të keqpërdorur taksat e njerëzve.

Unë e thashë që nuk jam specialist i fushës, por ato që ju them janë konstatime të drejtpërdrejta. Si mund të paguhet një drejtor i një projekti ndërkohë që atje nuk ka mjekë gjinekologë dhe gratë shtatzëna duhet të shkojnë në Lezhë të bëjnë vizitë. Kjo është e pandershme, të paktën, për mua që jam përfaqësues i këtyre njerëzve dhe kërkoj nga ju që të mos mbështesim fondet në një drejtim dhe të neglizhojmë problemin. Unë nuk mendoj se as gjendjen e spitalit e Burrelit dhe as në spitale të tjera e zgjidh ky apo ai projekt. Kjo na imponon që duhet të jemi më të kujdesshëm në përdorimin e këtyre fondeve, sidomos në transparencën nga ana e ministrisë kur kërkon mbështetjen për hua të tilla. kështu që, në

situatën që jam, ndershem nuk do ta refuzoja dot kurrë mbështetjen për të ndihmuar sistemin shëndetësor, por nuk mundem, gjithashtu, të jap mbështetje kur ka një mungesë transparence dhe destinacioni të këtyre fondeve. Në pritje të një sqarimi, më shumë, jam drejt një abstenimi të një situatë të tillë.

Mimi Kodheli - Faleminderit, kolegu Çollaku!

Parapara se t'ia kaloj fjalën zëvendësministres për përgjigjet, unë mendoj se do të ishte e drejtë që ne këtu, si anëtarë të Kuvendit të Shqipërisë, vijmë nga zona të ndryshme të Shqipërisë mund të kishim nevojë për sqarime të mëtejshme, të ulemi bashkërisht dhe t'i kërkojmë me shkrim ministrisë sqarime për situatën në të cilat ndodhen spitalet respektive, mungesat që janë në specialitete të ndryshëm dhe propozime lidhur me nevojat urgjente që ajo zonë mund të ketë. Këtë e thashë, pasi ne mund ta bëjmë këtë krejt normalisht, madje keni mbështetjen time si kryetare komisioni për ta çuar këtë mesazh dhe këtë shqetësim në ministri dhe për ta vënë ministrinë në një presion pozitiv për të kthyer përgjigje të detajuar lidhur me të gjitha shqetësimet që vijnë nga zonat.

Zonja Zëvendësministre, fjala për ju.

Vjollca Braho - Faleminderit, zonja kryetare!

Për sa i përket pyetjes së parë që ajo të ketë një ndërveprim me spitalet private, unë, që në fillim të herës, kur bëra shpjegimin pse do të përdoren 25 milionë euro e shpjegova që është reformim shërbim spitalor në Republikën e Shqipërisë. Pra, në këtë fazë jemi duke bërë të mundur rikonstruksionin e spitaleve, të cilët u dëmtuan nga tërmetit i vitit 2019, si dhe vazhdimin e sistemit HIS, që është sistemi i digjitalizimit në shtatë spitale rajonale, ku 4 nga të cilat janë duke realizuar dhe mbarojnë në fund të vitit 2022, ka përfunduar vetëm spitali rajonal i Durrësit dhe me këtë hua do të bëhet shtrirja edhe në spikatet e tjera, por vetëm në spitalet shtetërore.

Për sa i përket pyetjes që bëri zoti Çollaku, në sqarimin tim unë nuk tregova që ky proces, qoftë për digjitalizimin, qoftë për rikonstruksionin ka filluar sot, është në vijimi dhe, sigurisht, nëse ju doni një informacion të hollësishëm për kredinë e marrë, mund t'i dërgoni shkresë Ministrisë së Shëndetësisë dhe ne mund t'ju dërgojmë në mënyrë të hollësishme se çfarë është bërë, megjithatë, mund t'ju them se me kredinë e parë që është marrë, në vlerën 32,1 milionë euro, është bërë i mundur rikonstruksioni i Pediatriisë të Qendrës Spitalore Universitare, ku ka përfunduar faza e parë dhe ka filluar faza e dytë, është bërë rikonstruksioni i spitalit të Kukësit, ndërtimi i spitalit të ri në Kurbin, si dhe janë blerë pajisje mjekësore për 11 spitale rajonale, si dhe një sërë shpenzimesh të tjera, të cilat, nëse ju

dëshironi, në mënyrë analitike unë mund t'ju dërgoj pranë komisionit për Politikën e Jashtme.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Shehu, pastaj zoti Alizoti.

Tritan Shehu- Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, duhet t'i ndajmë disa gjëra. Ne jemi Komision i Jashtëm, unë jam edhe anëtar i Komisionit të Shëndetësisë dhe atje diskutojmë problemet e reformës shëndetësore, spitaleve dhe qendrave shëndetësore, por këtu, si Komision i Jashtëm, ne e shohim në këtë prizëm, pastaj debatin e përgjithshëm di ta bëjmë në seancë plenare. Nëse do të më pyesnit mua, unë do të thosha që, si Komision i Jashtëm, nuk shoh pengesa për këtë kredi, sepse janë forma kreditimi që ne i kemi marrë historikisht në Shqipëri nga Banka Botërore dhe, pa dyshim që nuk ka ndonjë problem.

Në lidhje me termat financiarë, zonja e Ministrisë së Financave më tha terma pozitive, që janë të pranueshëm, janë terma normalë, që mund të merren, pasi është tjetër gjë në suazën e borxhit të përgjithshëm, atë duhet ta diskutojë Ministria e Financave, ose Komisioni i Financave.

Për diskutimin që u hap këtu për planin e çështjeve të holla, të veçanta shëndetësore, unë i shpreha mendimet e mia edhe në Komisionin e Shëndetësisë, atje kam objeksionet e mia të forta për këtë kredi, për mënyrën e objektivave të saj, për zgjerimin e saj pafund, për thërrmimin e saj, për kalimin në element propagandistik dhe jo në element real të zhvillimit shëndetësor, sepse, në fund të fundit, të jemi realistë, e thashë edhe në Komisionin e Shëndetësisë, 25 milionë janë shumë pak për sistemin shëndetësor, nuk janë asgjë realisht. Janë një thermi për atë që ka nevojë sistemi shëndetësor në tërësi. Kështu që, nuk mund të thuash se do të bëj që nga dëmet e tërmetit, deri tek informatika, deri tek autonomia spitalore, sepse kjo do të thotë që efienca dhe efikasiteti i një financimi të vogël, modest, është shumë modest, për të qenë realistë, të hollohet, sepse kërkohet t'u jepet të gjithëve nga një thërrime për efekte propagandistike.

Në qoftë se flas për anën profesionale dhe jo si anëtar i Komision të Jashtëm, sepse këtu ndahen, unë jam dakord me atë që tha Kreshniku, ne nuk mund të diskutojmë për këtë, pa diskutuar ku shkuam, çfarë bëjmë, çfarë arritëm, objektiv për objektiv, me kredinë e parë të bankës, sepse kjo është vazhdim i saj, prandaj unë do të abstenoj në tërësi, duke gjykuar të gjitha elementet, qoftë elementet e politikës së jashtme, që jam dakord, qoftë elementet me impakt të drejtpërdrejtë në sistemin shëndetësor, që unë kam objeksionet e mia të forta për këtë gjë dhe do t'i ngre në seancën plenare.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shehu!

Nënkryetar, fjala është për ju.

Tomor Alizoti – Edhe unë kam dy fjalë. Unë do ta trajtoj jo nga koncepti i politikës së jashtme, e komisionit që jemi, por nga ana më njerëzore. Edhe unë i bashkëngjitem zotit Çollaku, që nuk jemi ekspertë të fushës, por jemi njerëz që kemi kontakte me spitalet. Unë, fatkeqësisht, duhet ta them se historikisht kam pasur kontakte me spitale shtetërore. Nuk kam pasur aq financa sa të përballojë spitalet private, duke filluar nga prindërit, kam pasur edhe një situatë shumë të vështirë me një nga fëmijët e mi, dhe kam parë, kjo nuk lidhet me ju, kjo është historia e shëndetësisë shqiptare, që në spitalet shtetërore shqiptare përjeton një tragjedi të madhe si njeri. Nëse nuk ke financa...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po ndaj shqetësimin tim. Unë kam kaluar kohë të gjatë nëpër spitale, vetëm shtetërore, dhe kjo ndoshta është një thirrje për të gjithë. Kjo nuk duhet të jetë një çështje politike, por duhet të jetë një çështje shumë njerëzore, se njerëzit kalojnë tragjeditë më të mëdha të jetës së tyre nëpër spitale shtetërore. Unë sinqerisht kam parë atje, në të gjithë përjetimin tim nëpër spitale, tragjedi, njerëz të varfër, njerëz që nuk i shihte njeri me sy, herë punonte skaneri, herë nuk punonte skaneri. Pra, mjekësia është diçka shumë themelore, që ne duhet të merremi shumë seriozisht dhe do të thosha që është sinqerisht një mëkat i madh, që të futen duar në ato financa, ndaj një populli shumë të varfër, po e them më shumë nga ana njerëzore, i cili të gjitha kursimet e jetës së tij i lë në spitalet shtetërore, në private po e po, për të mbijetuar dhe shpëtuar të afërmit e tyre. Unë kam pasur një përvojë, mjekët kanë qenë të shkëlqyer, por njerëzit, pajisjet, niveli përbëjnë një nga tragjeditë më të mëdha që mund të të bjerë, përballja me spitalet dhe kjo nuk duhet të jetë në këtë nivel. Unë bie dakord me zotërinjtë, që shëndetësia është një gjë shumë e kushtueshme, por të paktën të mos kemi këto standarde.

Ka 30 vjet që kemi hyrë në një sistem tjetër dhe ende nëpër spitale prishet një pajisje, s'punon një tjetër, njerëzit kanë dikë të sëmurë me një sëmundje drejt vdekjes, kanë një fëmijë të sëmurë, që edhe mund t'ju vdesë. Pra mendoj, pa hyrë në detaje, nuk është çështje shkresash. Një qeveri apo një shtet përballohet te konsumatori. Është financa mirë, sa para ka qytetari në xhep, funksionon shëndetësia mirë, sa i kënaqur është qytetari që përballlet me shëndetësinë, ky është vlerësimi më i mirë. Unë kam përshtypjen që këtu ka shumë për të dëshiruar dhe kjo ishte më shumë nga efekti njerëzor. Do të dëshiroja të kishte sa më shumë shmangie të menaxhimeve, të projekteve, sepse këto më duken boshllëqe për të rrjedhur para,

më mirë në pajisje, te mjekët, te njerëzit që bëjnë punë reale, këta janë mjekët dhe pajisjet që kushtojnë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, nënkryetar!

Zonja Gjonaj, fjala është për ju.

Ndërkohë, krejt miqësisht, kërkoj mirëkuptimin tuaj, përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë kanë një komision tjetër, kështu që do të uroja, pas ministres Gjonaj, të mos kishim diskutim tjetër dhe përtej gjithë sensibilitetet që vetë shëndetësia sjell te gjithsecili prej nesh, gjithsekush ka eksperiencat e veta, unë nuk kam asnjë eksperiencë në spitalet private, i kam të gjitha në spitalet shtetërore, diku shumë të mira, diku më pak të mira, mbetem shumë e kënaqur me çka kanë shërbyer njerëzit e sistemit të shëndetësisë në spitalet tona.

Ministre, fjala është për ju.

Etilda Gjonaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë i falënderoj edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, gjithashtu edhe zëvendësministren e Financave!

Pa dyshim bie dakord me kolegun Shehu, kur thotë që për sa kohë kjo është një marrëveshje dhe në përgjegjësinë e Komisionit të Politikës së Jashtme nuk ka asnjë pengesë dhe ne jemi shumë në rregull, por mirëkuptoj edhe kolegët e opozitës kur ngrenë shqetësime të ndryshme për sa u përket problemeve shëndetësore të spitaleve në zonat e tyre elektorale, apo historive personale. Unë besoj se, jo të gjithë, por pjesa më e madhe jona jemi njerëz që frekuentojmë spitalet publike, ne apo familjarët tanë.

Për hir të së vërtetës, ka gjëra që duhen bërë dhe ka nevojë për më shumë investime, por duhet të kuptojmë ku ka qenë situata dhe si ka qenë gjendja para shumë viteve dhe si është sot. Ka një ndryshim rrënjësor dhe këtë e them me shumë bindje, sepse kam qenë dëshmitare jo vetëm thjesht e buxhetit, apo investimeve, që janë bërë në shëndetësi, duke qenë pjesë apo anëtare e kabinetit qeveritar, por edhe në atë çka kam parë vetë, kur kam pasur edhe unë nevoja për të marrë shërbim shëndetësor publik.

Gjithashtu, duhet të kuptojmë dhe të rikujtojmë investimet e jashtëzakonshme që janë bërë, jo vetëm thjesht me marrëveshje të tilla të ngjashme, por edhe me marrëveshje apo buxhete dhe aspekte të tjera financiare, që janë dhënë për sektorin e shëndetësisë. Ne sot numërojmë rreth 300 qendra shëndetësore, të cilat janë rehabilituar dhe ndërtuar nga fillimi. Ka qenë një skëterrë të shkoje në një vend të vogël dhe të kishe një qendër shëndetësore të mbaruar, ose nuk kishte fare qendër shëndetësore. Kemi sot një sërë investimesh të mëdha,

siç janë maternitetet e disa vendeve, si: Lezha, Berati, Saranda, Korça, apo pediatri, të cilat, për hir të së vërtetës, kanë pasur një problematikë shumë të madhe dhe sot kemi pediatri, si: në Elbasan, Durrës, Tiranë apo edhe në qytete të tjera, që janë model, që nuk i gjen ndoshta edhe në vende të tjera të Europës, prandaj duhet të jemi realistë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, e them edhe nga eksperiencia personale. Duhet të jemi realistë në atë çfarë kemi dhe çfarë është bërë. Patjetër që kushdo nga ne do të donte të kishte një shërbim me infrastrukturë shumë herë më të mirë, por duhet të kuptojmë çfarë kemi pasur dhe gjërat nuk mund të arrihen me një të rënë të lapsit apo brenda ditës. Duhet të kuptojmë që është një proces i tërë dhe reformat që ka marrë Ministria e Shëndetësisë dhe vetë ministrja Manastirliu, kanë qenë të jashtëzakonshme për sa i përket menaxhimit të sistemit shëndetësor. Të mos harrojmë pandeminë, të mos harrojmë situatat, të cilat, në fillimet e saj, kishin nevojë për një ndryshim radikal dhe patjetër e gjithë pjesa e investimeve do të fillojë të plotësohet edhe me marrëveshje të tilla, që njëkohësisht japin një mundësi financiare, por pa dyshim buxheti i shtetit ka qenë gjithë kohën i fokusuar te shëndetësia. Unë besoj se, pavarësisht se kuptoj edhe problematikën që mund të kemi hasur, apo që mund të keni hasur ju, është një marrëveshje që do t'i japë në njëfarë mënyre frymëmarrje edhe sektorit të shëndetësisë për të kryer ato investime për të cilat ka nevojë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Ministre!

Dakord, e hedhim në votim.

Kush është dakord me projektligjin? Kundër? Abstenim? 4 abstenime.

Miratohet.

Neni 1 i marrëveshjes, ju lutem! Kundër? Abstenim? 4 abstenime.

Miratohet.

Neni 2, ju lutem! Kundër? Abstenim? 4 abstenime.

Miratohet.

Edhe njëherë në tërësi projektligjin, ju lutem!

E konsiderojmë të miratuar.

Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Faleminderit, kolegë të ministrive respektive!

Faleminderit, kolegë të komisionit!

Shihemi të enjten në seancë.

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA